

**nga**  
**Çelësi**

**KULT**

E përjavshme informative kulturore  
Botim i gazetës "Çelësi"  
Nr. 133- E mërkurë, 5 prill  
Çmimi: 200 lekë, 2 euro

# Çmimet KULT sjellin Ana Visin në Tiranë

Një spektakël i rrallë!  
Yjet e artit shqiptar dhe  
të ftuar specialë nga bota!

**Të gjithë më 9 prill,  
ora 20.30,  
në Pallatin  
e Kongreseve**

**Nga Kliton Nesturi**  
Për më shumë Dinjitet

**Koncert**  
Von Spar në Pallatin  
e Sportit "Asllan Rusi"

**Opera**  
Agim Hushi, arie dhe  
muzikë napolitane


**Festivali**  
Rin-fest, gara  
mbarëkombëtare në QNK

**Koncerte**  
Duo Jazz +One Projekt" në  
Akademinë e Arteve

**Teatër**  
"Pak i martuar"....,  
në Vlorë

**Kinema Milenium**  
"Munich", një mision  
hakmarrjeje

**Votoni artistin tuaj të  
preferuar!  
Dërgo SMS në 15 13**



spektakël  
përsëritshëm  
surpriza  
të ftuar specialë  
12 çmime  
të mëdha



# Spiros Eksaras:

“Muzika le të bëhet dirigjenti i paqes në botë”

Spiros Exaras është kitaristi i grupit xhaz grek “Duo Jazz Plus One”, i cili erdhi këtë javë në Tiranë. Eksaras ka shumë simpati për publikun shqiptar. E ka ndërjerë se ky publik e kupton mjaft mirë atë dhe mesazhin që ai do të përcjellë me muzikën e tij xhaz. Ka qënë në Shqipëri vitin e kaluar dhe mbresat e shkëlqyera e kanë entuziasmuar pa masë. “Me zor e prisja ardhjen në vendin tuaj”, - thotë ai në një intervistë ekskluzive për revistën “Kult”. Me një eksperiencë të gjatë dhe bashkëpunime të shumta ndërkombëtare, Exaras pranon se kontaktet me muzikantët shqiptarë kanë qënë shumë të këndshme, duke shtuar se do të vazhdojnë dhe në të ardhmen. Përveç tij, ky grup përbëhet nga Jiana Katsageorgi dhe Kostas Baltazanis. Grupi jep dy koncerte, të mërkurën më datë 5 prill, në orën 7, në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe, të dytin, në qytetin e Durrësit, në orën 6, në Galerinë “Jozef.” Pjesa e parë e programit do të përfshijë muzikë xhazi ndërsa pjesa e dytë do të përmbajë këngë greke kryesisht të kompozitorëve të shquar grekë, Mikis Theodorakis dhe Manos Haxhidhakis. Eksaras ka studiuar kitarë klasike dhe kompozim në Konservatorin e Athinës. Ka filluar të luajë që në moshën 16 vjeçare. Ka qënë kitaristi lider i “Orkestrës Kombëtare të Radio Televizionit Grek” (ERT) dhe ka performuar shpesh me “Orkestrën e Ngjyrave” (Orchestra of Colors.) Albumi i tij i parë, i realizuar në bashkëpunim me Kostas Haxhis, doli në vitin 92. Po në këtë vit, ai “zbarkoi” në Amerikë, ku luajti në klubet më të famshme të Nju Jorkut, duke sjellë një tingull të ri të përfituar nga kombinimi i xhazit klasik me muzikën greke. Fiton famë dhe interpreton krahas Randy Brecker, Harvie S., Mark Egan and Philip Hamilton, Richie Morales, Dave Valetin (fituesi i Çmimit Grammy) si dhe shumë të tjerëve. “Ansambli Botëror i Xhazit Spiros Exaras”, i cili përmbledh disa nga muzikantët e njohur të botës si pianistin Hery Hey, basisti Matt Garrison, bateristi Gene Lake, vokalisti Arto Tunçboyacıyan dhe klarinetisti Lefteris Bournias, themeluar prej tij, ka nxjerrë pak kohë më parë albumin e fundit “Phrygians”.

**Revista “Kult”:** Përse zgjodhët përsëri vendin tonë për të dhënë koncert?

Në fakt kemi dhënë dy koncerte në Shqipëri shtatorin e kaluar. Kjo eksperiencë ishte e mahnitshme jo vetëm se për herë të parë interpretova bashkë me muzikantë shqiptarë, por edhe sepse pritja dhe reagimi i publikut ishte fantastik. Dukej që e pëlqenin xhazin edhe pse është një zhanër jo shumë i njohur në Shqipëri. Gjithashtu ky publik pëlqeu faktin se një fqinj grek erdhi që nga Nju Jorku për të luajtur pakëz “xhaz ballkanik”...

**Revista “Kult”:** A do të vazhdoni bashkëpunimin me muzikantët shqiptarë?

Bashkëpunimi me muzikantët shqiptarë gjatë turit tim të kaluar artistik ishte shumë i mirë. Jam i sigurt se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

**Revista “Kult”:** Kur e keni filluar karrierën si muzikant?

Isha vetëm 16 vjeç kur vendosa të ndjek “rugën e vështirë” të muzikantit pasi i mora parasysh të gjitha vështirësitë që më duhej të përballoja.

**Revista “Kult”:** Përse zgjodhët pikërisht xhazin?

Sepse është i vetmi stil muzikor që të fal shumë liri në interpretim dhe në shprehje. Është shumë intriguese të jesh bashkëkompozitor i një këngë, të jesh i aftë të ndryshosh kordat ose ritmin, të improvizosh ndërsa bën këto ndryshime dhe ta çosh këngën në një dimension ose shkallë tjetër.

**Revista “Kult”:** Kush është tematika kryesore e këngëve tuaja?

Është diçka midis Lindjes dhe Perëndimit, një lidhje ose një “marrëveshje midis kulturës Lindore dhe asaj Perëndimore.

**Revista “Kult”:** A është “Phrygians” hiti juaj më i mirë?

Po. “Phrygians” është vepra ime më e mirë, duke marrë parasysh faktin se është pritur kudo në botë me shumë entuziazëm nga kritika. E konsideroj si veprën më të mirë që kam realizuar deri më tani sepse kompozimet janë



të “skalitura” mirë dhe kombinojnë xhazin me të gjithë elementët e tjerë ballkanikë, që i japin pikërisht asaj këtë aromë të veçantë. E hedhur në treg nga kompania muzikore Blue Note Records, ky album përmban këngë të regjistruara, të miksuara dhe të realizuara në Nju Jork nga inxhinierët më të mirë të industrisë së muzikës. Pikërisht “Phrygians” më bëri të parin muzikant grek që ka nënshkruar me Blue Note Records dhe kështu më klasifikoi në kategorinë e muzikantëve të njohur në botë.

**Revista “Kult”:** Cili është “burimi” juaj kryesor i frymëzimit?

Vajza ime, Ileana, është një frymëzim i përditshëm. Ajo është një arsye e fortë për mua për të përmisuar vetveten dhe për të “Mbajtur Premtimin”, siç quhet një nga këngët e mia. “Deer’s Leap” (Kërcimi i kaprollit), një nga këngët e “Phrygians”, është frymëzuar dhe kompozuar pikërisht për të.

**Revista “Kult”:** Cili do të ishte mesazhi për fansat tuaj, por dhe të muzikë jazz në tërësi?

Unë besoj se arti është e vetmja gjë që na ka mbetur për tu folur zemrave të njerëzve. Sidomos muzika është arti që mund të ngjyrosë me tinguj dhe tinguj mund të nxjerrin ngjyra. Mesazhi im për fansat që ndjekin është: “Jini dinjitozë dhe mos pranoni të komprometoheni nga momenti. Lereni udhëheqësit të dëgjojnë më shumë muzikë, që ajo të bëhet dirigjenti i paqes në botë”.

Intervistoi: Rudina Hoxha